



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 33/ 2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga Muhamet Rexha, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) në lidhje me parregullsi gjate procesit zgjedhor, në seancën e mbajtur më 11.01.2011, mori:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

ARSYETIMI

Më datë 09.01.2011 PZAP-i ka pranuar ankesë nga LVV në të cilën thekson se “me datën 09.01.2011 rreth orës 16:00 në Drenas, fshati Negrovc, Arllat dhe Llapushnik është ndalur rryma. Në fshatin Negrovc është ndalur përkohësisht votimi, ndërsa në Arllat dhe Llapushnik është lejuar votimi përkundër asaj që nuk ka rrymë. Parashtruesi i ankesës ka përmendur si dëshmitar emrat e komisionereve dhe vëzhguesve të QV në Arllat dhe Llapushnik”.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

3.6 (c) Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstaton se ankesa është e pabazuar për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së dhe elementet e parashikuara në nenin 3.6 pika c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, për shkakun se parashtruesi i ankesës nuk ka arritur të dëshmojë se është dëmtuar procesi i votimit si mungesë e energjisë elektrike në vendvotimet respektive, për më tepër pala ankuese nuk i ka bashkangjitur ankesës ndonjë provë materiale si dëshmi, që do të bënte të besueshme ekzistimin e shkeljes së pretenduar. Për këto arsye dhe bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 33/2010 më datën 11.01.2011.

Kryesuesi i Panelit

Muhamet Rexha

